



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 21.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.01.2025, të parashtruar nga ARM ENERGY GROUP SHPK – PRISHTINE lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim”, me Nr. të Prok: 613-24-13138-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet pjesërishtë e bazuar, kërkesa për ri-shqyrtim e ARM ENERGY GROUP SHPK – PRISHTINE të dt. 20.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim”, me nr. të Prok: 613-24-13138-1-1-1.

Sa i përket kërkesës nr 1 të kapaciteti teknik dhe profesional që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për furnizim me dru zjarri në vlerë prej 1,200,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate, (në rast të grupit të konzorciumit lideri duhet të ketë së paku 60% të kërkesës), AK vendos që kjo kërkesë të mbetet në fuqi në bazë të kërkesës së njoftimit për kontratë si dhe dosjes së tenderit.

Ndërsa sa i përket kërkesës nr 3 poashtu të kapaciteti teknik dhe profesional që Operatori Ekonomik duhet të ofroj pajisje teknike a. Kamion min 10 m3 - min (3 copë), AK vendos që kjo kërkesë të përmiresohet duke bërë njoftim për informata shtesë ose përmiresim gabime me anë të formularit B54.


1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtör i Prokurimit